



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planimir / Datozuar Prilbena / Protdata Received / Delivery	28-04-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHCK	3955/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 525/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.525/2023 të datës 17.03.2023, të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ nga Ferizaj, kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 28.04.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.525/2023 e datës 17.03.2023, e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_

### A r s y e t i m

Nëpunësja civile \_\_\_\_\_ (me tej vetëm ankuesja), e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 17.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet që të rivlerësohet kategorizimi i ankueses nga klasa profesional 3 në profesional 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli), në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit më datë 07.04.2023 ka përcjell shkresat ndërlidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe së e njëjta sipas Aktit të Emërimit me Nr. Ref:DRGJC/ARC-11/3 të datës 31.01.2013 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Nëpunëse Administrative në QKRS në Prishtinë*, me koeficient gjashtë (6) të pagës, ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja në listën e pagave të muajit shkurt është kategorizuar në klasën profesional 3.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së bazuar në kualifikimet dhe përvojën e ankueses si dhe përgjegjësinë e detyrave të punës pozita e ankueses është e barasvlershëm me klasën profesional 2, e jo profesional 3 ashtu siç është propozuar nga organi i punësimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj"*, dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjësisht deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankueses lidhur me

kategorizimin e pozitës së saj në kategorinë profesionale 3 është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim merititor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankueses i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.525/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

  
Procesmbajtëse

Arçita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

